

V E N D I M
Nr.450, datë 1.7.1998

PËR ADMINISTRIMIN E QYTETIT ANTIK TË BUTRINTIT

Në bazë të ligjit nr.7867, datë 12.10.1994 "Për mbrojtjen e pasurive kulturore, të luajtshme dhe të paluajtshme", me propozimin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar dhe të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Qyteti antik i Butrintit, si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore, kombëtare dhe asaj botërore, vihet tërësisht në konservimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Krijohet "Zyra e administrimit dhe e koordinimit" në Sarandë, në varësinë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për administrimin e Qytetit-antik të Butrintit. Rregullorja e funksionimit të kësaj zyre miratohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

Zyra e administrimit dhe e koordinimit ka këto funksione dhe detyra kryesore:

a) realizon dhe monitoron programet e zhvillimit dhe të administrimit, të miratuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Akademia e Shkencave, Komiteti i Zhvillimit të Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet tyre;

b) mban kontaktet dhe marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë, me fondacione dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, që shprehin interes për programe zhvillimi ose donacione;

c) administron të ardhurat që krijohen nga veprimtaria turistike dhe veprimtaritë e tjera;

d) kryen detyra të tjera, të caktuara në rregulloren e funksionimit të kësaj zyre.

3. Zyra e administrimit dhe e koordinimit në Sarandë, ka një personel prej katër vetash, përfaqësues-specialistë të Institutit të Monumenteve të Kulturës, të Institutit të Arkeologjisë, Komitetit të Zhvillimit të Turizmit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Zyra bashkëpunon me Bashkinë e Sarandës, e cila cakton një përfaqësues të saj pranë kësaj zyre.

Drejtori i zyrës koordinuese emërohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, kurse përfaqësuesit specialistë caktohen nga institucionet përkatëse.

4. Krijohet bordi i administrimit dhe i koordinimit të qytetit antik të Butrintit, me qendër në Tiranë, me këtë përbërje:

- | | |
|--|---------|
| - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | kryetar |
| - Drejtori i Institutit të Monumenteve të Kulturës | anëtar |
| - Drejtori i Institutit të Arkeologjisë | anëtar |
| - Kryetari i Komitetit të Zhvillimit të Turizmit | anëtar |
| - Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit | anëtar |

5. Bordi i administrimit dhe i koordinimit të qytetit antik të Butrintit miraton strategjinë e zhvillimit të zonës dhe brenda një muaji nga data e miratimit të Buxhetit të Shtetit, nënshkruan marrëveshjen vjetore. Në marrëveshje përcaktohen:

a) Mënyra e bashkëveprimit ndërmjet institucioneve të bordit dhe të institucioneve që ato kanë në varësi.

b) Programi i detajuar dhe i bashkërenduar i veprimtarive të institucioneve që kanë në varësi.

c) Detyrat kryesore të specialistëve të zyrës koordinuese.

d) Masat për zhvillimin dhe administrimin e zonës

e) Shpërndarja e të ardhurave nga veprimtaria turistike dhe veprimtari të tjera në raport me fondet financiare të përdorura nga secili institucion, që është në varësi të tyre, dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit. Këto të ardhura kalojnë tërësisht për ruajtjen, mbrojtjen, gërmimet, restaurimin, marketingun dhe menaxhimin e zonës.

6. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me Bashkinë e Sarandës, të sigurojnë mjediset e nevojshme për sistemimin dhe funksionimin e zyrës.

7. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të përballojë shpenzimet e nevojshme për krijimin e zyrës koordinuese në Sarandë, brenda buxhetit të saj të miratuar për vitin 1998, ose nëpërmjet donacioneve.

8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Akademia e Shkencave, Komiteti i Zhvillimit të Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano